



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË DYTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 27.02.2018 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira, Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu këshilltarët e Kuvendit, Vjollca Kadolli-Halili, Basri Sylejmani, Rufadije Halimi-Rexhepi, Valbona Haziri, Afrim Ramushi, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Zekirja Zuka, Blerina Lubishtani, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesja e Zyrës Ligjore, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, z.Hasan Aliu, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, mediat e shkruara dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Ju njoftoj, se nga Zyra Ligjore e MAPL-së kemi marr konfirmimin lidhur me ligjshmërinë e akteve dhe ju informoj, se komitetet të cilët i kemi formuar na kanë dhanë vërejtje për shkak të mos përfaqësimit gjinor në baze të Ligjit për Barazi Gjinore, MAPL-ja po insiston që të gjitha komitetet që dalin nga Kuvendi Komunal të keni përfaqësonim adekuat gjinore me 50%. Unë kam dërguar edhe punëtorët e Zyrës së Sekretarisë së Kuvendit që të diskutojnë një konfirmim gojor, andaj kanë thanë, që mundeni të vazhdoni me komitetet. Kështu si i kemi formuar na, një problem i tillë është thuaja se me 80% te komunave ne nivel vendi. Edhe njëherë po tham, me gojë na kanë thanë, që mundeni të vazhdoni punën me këto komitetet, por ne do të shofim, aty ku kemi mundësi do t'i bëjmë ndryshim plotësimet dhe me përfill Ligjin për Barazi Gjinore. Unë tjetër nuk kam, kaloj tash tek pyetjet dhe propozimet, edhe pse në mandatin e kaluar, me propozimin e këshilltarëve komunal ka qenë si pikë jashtë rendi dite, ku kemi diskutu në kohen prej 30 minuta. Meqenëse, në seancën e kaluar disa këshilltar komunal ishin të interesuar që mos të limitohet kjo pikë dhe të diskutohet për çështje dhe problematika të ndryshme. Unë me pëlqimin e juaj propozoj, që kjo pikë e rendit të ditës të mbetet në fund dhe ta kemi mundësinë që të diskutohet sa të ka nevojë, pasi

që ti përmbyllim pikat e rendit të ditës. Mendoj që është mirë dhe është një praktikë e mirë që po e praktikojnë edhe shumë komuna të tjera. Unë po e hapi diskutimin, që kjo pikë të mbetet si pikë e fundit e rendit të ditës.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje për të pranishmit! Mendoj që kjo pikë duhet të jete pikë e parë e rendit të ditës, nuk ka kurnifarë logjike, që pyetjet dhe përgjigjet të lihen në pikën e fundit.

znj.Mirlinda Sadiku: Edhe ne si grup i VV-së jemi kundër këtij propozimi, për arsyeje, se shpeshherë ka ndodhë që drejtorët pas pushimit të drekës nuk po kthehen në seancë dhe shumë pyetje të parashtruara po mbesin pa përgjigje.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Propozimin të cilin e dha kryesuesi nuk prish asgjë punë, por vetëm çka do ta zgjat punimin dhe do t'i shtjellojmë problematikat e komunës shume me gjatë dhe më mirë. Nëse pyetjet e përgjigjet jesin në fund të seancës, unë jam i mendimit që ky propozim të del në votim.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë mendoj, që legjislaturën e kaluar ka qenë gabim që kjo u diskutu me kohë zgjatje, nuk guxon pikë e rendit të ditës me caktu a zgjat pesë minuta apo gjysmë ore. Çdo pikë zgjatë aq sa ka nevojë, unë mendoj që duhet me qenë në fillim të seancës dhe le të vazhdojmë kështu me pikën e njëjtë si ka qenë deri sot.

z.Besim Ymeri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Mendoj që është shumë e arsyeshme që të lihet në fund, për shkak se e hupmi at rrjedhën e zhvillimit kontuniel të mbledhjes, dhe në fund është e arsyeshme me zgjatë edhe ma gjatë.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë kisha thanë, që nëse e lam në fund të seancës, atëherë edhe nënshkrimet ti marrim në fund të seancës, t'i nënshkruajmë për mëditje, për shkak se njerëzit pasi po e kryen po ikun, kështu ne fund të seancës edhe nënshkrimi i këshilltarëve edhe diskutimi.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje për të gjithë. Ky propozim po mendoj që është i qëllimshëm mi lanë në fund pyetjet e asamblistëve e mi kapërcye sa me lehtë kërkesat e qytetarëve. Është e drejt elementare e çdo anëtar i Kuvendit qyshe në fillim me i shtru kërkesat e qytetarëve, kuptohet kërkesat e arsyeshme. Nuk e di pse mi lanë në fund. Mendoj që duhet me vazhdu qyshe kemi vazhdu mandatin e kaluar me vazhdu edhe tash.

znj.Vjollca Kadolli-Halili: Përshëndetje për të gjithë! Edhe unë mendoj që propozimi i kryesuesit është qëllim mirë, sepse ne këtë mënyrë ju jepet hapësirë të gjithë këshilltarëve komunal që të debatojnë, ndërsa atë që e tha parafolësi, që është tendencioze, nuk mendoj që është, aq me pak të thuhet që ne lodhemi kur realisht ka mbledhje ku zgjatim dhjetë-dymbëdhjetë orë e nuk e di që ne kemi pas mbledhje që ka zgjatë ndonjëherë me shumë se gjashtë orë e atë me pauzë një orësh. Unë jam pro që në kalon propozimi i kryesuesit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë qes ne votim propozimin tim, që kjo pikë të lihet në fund të rendit të ditës që të diskutohet. Kush është që kjo pikë të shkoj në fund të seancës me ngritje dore ju lutem. Me 14 vota për, 12 kundër, 1 abstenim, kjo pike e rendit të ditës lihet në fund të seancës për tu diskutuar.

Për seancën e dyte te rregullt të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pare e KK-Vitisë.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për pezullimin e përkohshëm të nenit 21, nënti 13 pika 13.6 dhe nenit 41 të rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit me nr.01-013/1688 të datës 24.11.2014, për dhënien në

shfrytëzim afatgjatë pronat e Komunës Kompanisë Eko-Energjis SH.P.K- Pozharan për ndërtimin e minihidrocentralit me kapacitet 0.60 MW.

- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për emërimin e komitetit për Arsim, Kulture, Rini dhe Sport.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për emërimin e komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**
- 6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për emërimin e komitetit për Shërbime Publike.**
- 7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për emërimin e Komitetit për Planifikim.**

A ka dikush diçka rreth rendi të ditës?

znj.Mirlinda Sadiku: Grupi i VV-së propozon, që pika e tretë e rendit të ditës të shtyhet për seancën tjetër, sepse si grup i VV-së kërkojmë raport prej njerëzve profesionist, ingjiner te hidrologjisë, që të naj japin një përshkrim dhe një vlerësim të tyre profesional në lidhje me këtë hidrocentral, për arsye sepse, sipas informatave që i posedojmë nga terreni, vetëm ka plasarit aty qymenta dhe pjesa ku është ndërtu ky hidrocentral, prandaj për hirë të asaj, se ne do të votojmë për këtë propozim vendim, i cili do t'i atakoj edhe 20 vite gjeneratat e ardhshme, ne duam një vlerësim profesional të njerëzve te fushës.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Piken të cilën e shtrun grupi i këshilltarëve nga VV-ja e ka arsyeshmërinë e vet, por megjithatë kompetencën për çështje të cilën po e kërkon në aspekt profesional mundet me ta dhanë Ministrit ne sot edhe në atë përbërje kemi vendos për hapësirë ne kemi për lokacion të cilën e ka kërku kompania në fjalë dhe e kemi dhanë, ndërsa pëlqimin dhe të tjerat janë ministritë përkatëse, ministritë e linjës, të cilët i japin mendimin e tyre profesionale, tu fillu prej pëlqimit mjedisor e te tjerat. Në këtë rast edhe mu mu doket e pakuptim me ju thanë na ejani dhe jepna raport neve. Konsideroj i keni të gjitha dokumentet të bashkangjitura. Ne më herët i kemi dhënë vendimin për kapacitetin 0.60MW, por tani e ka rritur kapacitetin në 1.0MW e ne duhet të ja bëjmë ndryshim-plotësimi e vendimit nga 0.60MW në 1.0MW pa ndryshuar as kufitë e lokacionit apo asgjë tjetër.

znj.Mirlinda Sadiku: Jo gjithmonë ja qëllonjë ministritë fatkeqësisht. Nëse shikoni rrjedhën e lumit “Lumbardh” të Deqanit, e shihini çfarë katastrofe kanë bë komplet “Bisrica” ka hy nëpër gypa tu e dëmtu edhe ekosistemin edhe biodiversitetit edhe tu i shkatrru edhe ato male, prandaj kemi një provoj shumë të hidhur nga Deqani. Kërkesën që e bëra e di që në kuadër të Komunës ekzistoj ingjinerat, janë të kontraktuar nga komuna, nuk prish punë me shku me bë një vlerësim të asaj suate në çfarë gjendje gjendet ai hidrocentral. Kompania në fjalë, në kohen kur e ka marr pëlqimin prej këtij Kuvendi, ka pas një periudhë të hulumtimit 6-mujor. Çysh nuk e pa atëherë që ju nevojitet me bë 1 MW? Këtu u rrit hapësira në vitin 2014, kur është votu ka qenë 9410m², ndërsa tash kërkohet 8135m². Rritet kapacitetit po zvogëlohet sipërfaqja. Tjetra, neni 35 i Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L025, pikën 4 thotë: “Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet”. A ka bë komuna këtë?, prandaj për këtë arsyeje kemi dyshime. Me rritjen e kapaciteteve rriten edhe obligimet ndaj Komunës, a janë rrit edhe obligimet ndaj komunës?. Si dhe kërkohet raport i ekspertëve, nëse nuk ka komuna ekspert ka të drejt me kontraktu persona të caktuar të lemive të caktuar, që te japin një vlerësim, se tek e fundit hidrocentrali është tu ndërtua ne Viti e jo dikun tjetër. Neve na intereson opinion i personave dhe i komisionit përkatës.

Kruesesi z.Naim Pira: Qes në votim propozimin e grupit parlamentar të VV-së, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme, dhe të silllet raport. Me 10 vota pro dhe 14 kundër nuk kalanë propozimi i grupit parlamentar të VV-së, ndërsa me 14 vota pro konstatoj se u miratu rendi i ditës me këto pika që u ceken me lartë.

Pika e parë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pare e KK-Vitisë

Kryesuesi z. Naim Pira: Hap debat rreth procesverbalit.

znj. Mirlinda Sadiku, e cila i pat disa vërejtje për procesverbalin, kërkojë që të behën përmirësimet.

Kryesuesi z. Naim Pira: A ka dikush tjetër ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin me ndryshim plotësimet e kërkuara nga parafolësja. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për pezullimin e përkohshëm të nenit 21, nënti 13 pika 13.6 dhe nenit 41 të rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba

Drejtori z. Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Para juve e keni propozim vendimin, kjo ka të bëjë me rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba, që u miratu në seancën e janarit të këtij viti, Kjo ka të bëjë me taksat e biznesit, që janë të ngarkuar të gjitha bizneset pa përjashtim në Komunën e Vitisë, dhe ky pezullim ndodh prej vitit 2011. Është në favor të përkrahjes së bizneseve në Komunë të Vitisë për hirë të zhvillimit të tyre, të keni me të letë zhvillimin e tyre. Materialin e keni pranuar me kohë, për pyetje dhe përgjigje urdhëroni.

Kryesuesi z. Naim Pira: Hap debat.

znj. Vjollca Kadolli-Halili: Komuna e Vitisë gjithëherë ka qen në përkrahje të qytetarëve të Komunës së Vitisë, duke u munduar që të krijoj kushte të favorshme në zhvillimin e bizneseve dhe sidomos në krijimin e hapësirave ekonomike adekuate. Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendim.

z. Nijazi Isaku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht dua të pyes, se a ka hi në fuqi rregullorja e aprovuar në mbledhjen e mbajtur me datën 29.01.2018? Po, ne si material kemi pasur si plotësim ndryshim të rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba, por nuk është cekur as kund numri i protokollit apo datën, se për cilën ndryshim të rregullores bazike bëhet fjalë, ku p.sh.: neni 43 i kësaj rregullore shfuqizon rregulloren 28.04.2017. Nëse e shikojmë me perspektivë si ka ndryshuar kjo rregullore, është për tu ardhur keq, ka pas mungesë të profesionisteve apo çka nuk e di, por që ish njëra nder rregulloret që ka ndryshuar çdo vit apo edhe në gjashtë muaj, nëse bëjmë një krahasim me ndonjë komunë tjetër, sheh se në komunat maksimumi ishin deri në tre ndryshime prej fillimi të mandateve në asamble komunale. Po kur krahason komunën tonë, kemi tetë ndryshime prej vitit 2011 deri tani në 2018, ku çdo vit ka pas ndryshime, ku akoma nuk ndalet ky trend. Deri në fund të mandatit shpresojmë që mos këtë kesi plotësim ndryshime. Tani po ndalemi të ky propozim vendim, në aspektin ligjor a ka të drejtë si vendim ta shfuqizoj apo pezullon një akt normativ tjetër, si në këtë rast këtë rregullore, kur e dimë që vendimi ndryshon me vendim, e rregullorja ndryshohet me rregullore ose plotësim ndryshim rregullore. Lidhur me këtë kemi dispozitën e rregullores së Ministrisë të Pushtetit Lokal, ku thotë” “neni 12 shfuqizon apo ndryshim plotësimi i akteve normative behet me një akt normativ që i bëhet, nëse ndryshohet qe ky nen duhet me plotësim ndryshim apo është praktik që ka ndodhe deri tani me vendim me ndryshu rregullore?. Nëse shikojmë këtë propozim vendim për pezullimin e këtyre neneve, p.sh.: neni 13, pika 13.6, a do te thotë që anulohen edhe nenet, nënpika 13.6.1, 13.6.2 dhe 13.6.3, gjithashtu te neni 21, i cili përfshinë të gjitha bizneset dhe veprimtaritë afariste sipas llojeve dhe sipas kategorive, përfshirë marketet, punëtoritë, veprimtaritë e ndryshme, shërbimet ushqimore etj. Në bazë së cilës logjik keni shkuar, qe brenda një viti të mos ketë pagesa nga këto biznese e që i bie, që kjo paska ndodhe prej 2011. Nëse në rregullore pezullohet vazhdimësi prej 2011, pse figurojnë në rregullore e ne anën tjetër i pezullojmë, cila është kostoja, a ka kosto këtu, lidhje me këto falje a ka Komuna mungesë të madhe të hyrave me pezullimin e këtyre neneve?

z. Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë edhe në seancën e kaluar propozova që kjo të vazhdohet, ka qen një praktik shume e mirë në komunat e gjithë Kosovës, gati aty ky ka qeveris PDK-ja

ky propozim për qellim e ka pezullimin e këtyre neneve, ju bëhet një ndikim direkt bizneseve që operojnë në Komunën tonë. Unë e dëgjova me vëmendje parafolësin, tu e pa ekonominë e Kosovës se në çfarë gjendje është, unë po ju thamë, që në shtetet me të zhvilluar të botes, jo që taten po edhe subvencionohen bizneset. E kemi shembull Japonin, dikune prej 60% i subvencionon firmat e bujqësisë. Edhe unë prapë propozoj, që drejtori z.Ibrahim Rama, në pyetjet e parashtruara lidhur me këtë propozim vendim, a kemi të drejt të ndryshojmë rregullore, nëse e lexoni rregulloren që e kemi miratu ne muajin Janar, në nenin 22 thuhet: “Kuvendi Komunal, me vendim të veçantë do të vendos për pezullimin apo jo të zbatimit të neneve që kërkohet të pezullohen. A është ligjor ky vendim, shihet në preambulën e këtij propozim vendimi, parashihen që Kuvendi ka të drejtë të pezulloj këto nene. Kosto financiare për hir të pezullimit, prej vitit 2011 kanë ndryshuar të gjitha kriteret e parametrat për me caktu një kosto. Sa kishte me qenë ngarkesa e bizneseve p.sh.: për vitin 2018. Se prej vitit 2011 deri me sot kanë ndryshu edhe bizneset, një pjesë e tyre edhe janë shu, ndërsa një pjesë janë të reja, kështu që saktësisht për këtë kosto sa kishim me pas implikime drejtpërdrejt në të hyrat e buxhetit të Komunës së Vitisë, nuk kishe muajt me qenë i saktë.

z.Nijazi Isaku: Pyetja ishte në fillim, se a ka hy në fuqi rregullorja e mbajtur në mbledhjen e kaluar që nuk e kemi ne web faqe të Komunës? Sa i përket preambulës, unë e ceka në mënyrë profesionale, se ndryshim plotësimet e vendimeve bëhen me vendime, ndërsa rregulloret me rregullore, mirëpo një propozim vendim me ndryshu një rregullore nuk është në rregull.

Nënkryetari z.Hasan Alia: Po me vjen mirë, se po e shtjellon çështjen shumë më rëndësi të aspektit profesional, megjithatë plotësisht pajtoj me ata, se akti ndryshohet me emërtim të njëjtë, por megjithatë duhet ta kuptoj që këtu nuk kemi as ndryshim as plotësim, kemi pezullim të përkohshëm. Prandaj, pezullimin e përkohshëm mundemi ta bëjmë me vendim.

Kryesuesi z.Naim Pira: Akoma nuk ka ardhur konfirmimi i ligjshmërisë se rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim këtë propozim vendim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës me ngritje dore? Me 21 vota pro, 6 abstenime, konstatoj që u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit me nr.01-013/1688, të datës 24.11.2014, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronat e Komunës për Kompaninë “Eko-Energji” shpk – Pozharan, për ndërtimin e minihidrocentralit me kapacitet 0.60 MW.

Drejtoresha z.Fatbardha Emini: Përsëritje të nderuar të pranishëm! Materialin e keni të bashkangjitur. Kompania në fjalë të gjitha këto parcela i ka në bazë të vendimi për një periudhë 20 vjeçare ne shfrytëzim, andaj, e vetmja gjë që na duhet neve për shkak të procedurave, për hir të respektimi të Ligjit të Pronës së Dhënien në Shfrytëzim, i cili përjashton procedurat e investimeve në sektorin e energjisë, kërkoj nga ju që të bëhet ky ndryshim plotësim, ndërsa asnjëra nga parcelat nuk do të ndryshon, por vetëm në aspektin e kapaciteteve që është duke i prodhuar kompania në fjalë, ngase që të gjitha pëlqimet në kuadër të ministrive i ka me kapacitet 1 MW. Ky ndryshim i duhet, ngase që edhe për një periudhë dy a po tre mujore, ju ka pezullu kredia në bankë. Propozim vendimin me materialen e keni marr me kohë, për pyetje dhe përgjigje jam ne dispozicionin e juaja.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat për këtë pikë.

z.Remzi Salihu: Përsëritje të nderuar të pranishëm! Sa i përket kësaj çështje, unë kam analizuar disa gjëra dhe mund të them, se lidhur me propozim vendimin e prezantuar me është dashur që ti shfletoj disa materiale që kane të bëjnë me këtë propozim vendime. Së pari vendimi i datës 24.11.2014, pastaj propozim vendimi për ndryshim. Lejet e parapara me ligje, vendimi nga Ministria e Planifikimit Hapësinor; ndryshim vendimi për pëlqim ujqor; plotësimi elektro energjentik i KEDS-it; vendimi i Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit Hapësinor; vendimi për modifikim të autorizimit final nga bordi i ZRE-se të rregullatorit për

energji dhe duke pa se sa i përket aspektit ligjor gjithçka është në rregull dhe pasi që bëhet fjalë për një investim për interes për Komunën tonë dhe po ashtu pasi që investitori është nga Komuna jonë një gjë e tillë është e mundshme të behet dhe të diskutohet. Mirëpo, unë nuk jam pajtuar diçka këtu ose nuk kam mujtur të kuptoj një gjë, si është e mundshme, që në asnjë dokument nuk është cekur baza që mundëson ngritjen e kapacitetit të tillë nga 0.60 MW në 1.0 MW, dhe si është e mundshme të shtohet kapaciteti gjenerues pa kurfar ndryshimi tjetër në kapacitetin ujorë apo ndonjë element tjetër, ngase që nuk jam ekspert për këtë lëmi, prandaj mirë kishte me qenë që të na dorëzohet raporti profesional nga ekspertet e kësaj fushe, apo të kësaj lëmie, me mundësi që të konsultomi me këta ekspert të fushave të tilla, me qëllim që të dimë se çka po votojmë. Të jemi sa më të informuar, sepse është një projekt tejet me rendësi dhe me ndikimi në eko sistemin dhe në ambientin, i cili është në periudhën 20 vjeçare. Tek sa bëra krahasimin në mes të propozim vendimit për ndryshim dhe rekomandimit të komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës me nr. 01013/603, të datës 06.05.2014, i cili e rekomandon kryetarin e Komunës, që pronat, parcelat në zonën kadastrale Binçë, me sipërfaqe 15181 m² dhe parcelat apo pronat me sipërfaqe në zonat kadastrale në Kabash, me sipërfaqe pre 9410m², t'i jepet në shfrytëzim afatgjatë kompanisë "Eko energji" nga Pozharani. Duke i analizuar të gjitha këto tri dokumente, rekomandimin e komisionit, vendimin e Kuvendit Komunal dhe propozim vendimin për ndryshime të kryetarit të Komunës, shihet kjart, se kemi një mos përputhje mese rekomandimit të komisionit, vendimit komunal dhe propozim vendimi që u ardh sot. Pash se këtu ka mospërputhje në sipërfaqe, në metra katror. Në rekomandim thuhet, se në zonën kadastrale Kabash 9410m², pra, rekomandohet, kurse në vendim 8135m², ku dallimi është në 1275m². Nuk arrita ta kuptoj këtë dallim, është ndonjë gabim teknik apo mos mëshifet diçka këtu, a mundeni të ma shpjegoni këtë ndryshim? Se përndryshe, unë do të votoj kundër këtij vendimi, sepse nuk i kam të qarta disa gjëra. Po ashtu pyes, se a ka inspektor nga komuna në projektin e tillë apo ka qenë dikush në vendin e ngjarjes me i pa punët, se çka është punu aty, deri kur është ardhur dhe si qëndron puna.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje! Propozim vendimi që e kemi para vete është plotësim i vendimit që e kemi marr në vitin 2014. Vendimi që është leshu ne vitin 2014 ka qenë në harmoni dhe në përputhje me të gjitha ligjet ekzistuese që janë në Republikën e Kosovës. Atë çka kërkuam prej drejtoreshës në KPF, të kompletohet lënda, pikërisht ajo është bë, dhe ka ndodh në këtë propozim vendim. Si shtojce janë të bashkangjitur të gjitha vendimet e pëlqimet, që personi në fjalë i ka marr në ministri përkatëse, për fillimin e punëve që i ka bë ne këtë periudhë kohore. Ne, në vend që të jemi stimulues dhe t'i shtymë përpara bizneset, dalmi me shpjegime, që ndoshta nuk jemi kompetencë. Unë jam për ata, që ne t'i stimulojmë dhe t'i ndihmojmë e ti përkrahim bizneset. Fillimi i punës së këtij minihydrocentralit do të gjeneron vende të reja të punës dhe do të hynë në shërbim në vjeljen taksave të Komunës së Vitisë. Prandaj, ne si grup parlamentar i LDK-së jemi pro dhe jemi që kjo të miratohet.

z.Bekim Azizi: Unë kam disa dilema. Kur është bë plani për ndërtimin e hydrocentralit, ka qenë kapaciteti 0.60MW dhe a do të ketë mundësi rritje e 80% e kapacitetit për të njëjtin hydrocentral, t'i përballojnë paramasat, kur e dimë se për me rrit kapacitetin 80% do të rritet edhe 80% kapacitetit i ujit ka i marr ato burime të ujit. Nëse janë bë ato hulumtime me kohë, duhet të rritet mundësia e konstruksionit që është aty, e ndërtume për 80%, sepse rritet kapacitetit 80%. Dhe nëse do të rritet kapaciteti dhe komplet është plani dhe fuqia e objektit ekzistues, se ndoshta nuk do të mund t'i përballoj, atina kur do t'ia leni pasojat në të ardhme, që do të ketë pasoj, që nuk ka mundësi të përballoj një kapacitetit. D.m.th, unë mendoj që duhet të ketë një vëmendje, t'i kontrolloj, jan ingjinerat aktiv, ta shohin aty, sepse mos po del diçka me keq më vonë. Nuk besoj që dikush është kundër rritjes se biznesit, punësimit dhe për me e lehtësu bizneset, e miratum vendimin per me i liru prej taksave. Mirëpo, siç tha drejtoresha, nëse është vendimi vetëm sa me e marr ai kredinë, nuk besoj që duhet në këtë formë me e mëndu, kur te ja japim vendimi, ne na duhet me të vërtet të rritet kapaciteti, duhet të rritet punësimi. Unë mendoj që duhet të kemi një kujdesi në këtë aspekt.

z.Mirlinda Sadiku: Ashtu siç e tha kolegu Bekimi, askush nuk është kundër investitorëve as investimeve, aq më pak ne Kosovë, kur e dimë sa është numri i madh i papunësisë. Pyetje për drejtoreshën, ku kolegu e ceku d.m.th, vendimi i 2014-ës është 9410m². Tash e kemi 8135m², ka shtim të kapacitetit të hidrocentralit, mirëpo parcelat janë 1275m² me pak. Përgjegjësia bien mbi Komunën, mos e dhashtë Zoti të ndodh, që për shkak të punimeve të dobëta me pas ndonjë vërshim e të përmbytët lokalitetet, se na shumë pak punojmë në preventivë, vetëm kur të ndodh diçka veprojmë. A e keni marr parasysht nën 35 të Ligjit për Mirëmbajtje të Mjedisit nr. 03L/025, ku në piken 4 thuhet: se “komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet”. A e ka komuna planin e intervenimit për territorin e vet, nëse vinë prurje më të mëdhaja të ujit, kur e dimë që janar, shkurt, mars, sipas planit zhvillimor të Komunës. Dihet se “Morava” sjell ujë me tepër, a e keni parapa këtë?.

Kryesuesi z.Naim Pira: Meqenëse na u bashkëngjiti edhe kryetari i Komunës, shfrytëzoj rastin ta përsërisht.

z.Ekrem Abazi: Deshta t’i thamë Bekimit, që kontrollin që e kërkoje, ti kurrë nuk ka pas ne këtë Komunë, as në Kosovë as kontrollin nuk do të këtë, mos e ki gajle për atë punë. Sa i përket kësaj pike, pasi që i ka plotësuar me dokumentet e nevojshme nga ministria, unë në KPF kam qenë kundër kësaj pike, se nuk ka pas material, ndërsa tani na u ka përcjell materiali që e kemi kërkuar ne, unë jam për me votu pro këtij propozimi. Përgjegjësitë nuk i marrim ne si këshilltarë, i merr kryetari dhe ministria përkatëse për këtë punë.

z.Besim Ymeri: Përsërisht të nderuar! Unë kërkoj që të obligohet ndërmarrja “Eko Energji”, që të bashkëpunoj me shkollën e mesme profesionale “Jonuz Zejnullahu”, që nxënësit e saj të drejtimit të energjetikës, të kenë qasje në kryerjen e praktikës profesionale. Po pse jo, edhe gjate punës së montimit të këtij centrali, ku nxënësit do të fitojnë ide të reja.

Drejtoresha znj.Fatbardha Emini: U ngritën disa çështje, po për anëtarët e Kuvendit, të cilët janë këtu, mandej është e kuptueshme, por për ata të cilët e kanë miratuar këtë propozim vendim, edhe në vitin 2014, ku ju e shifni që vendimi i vitit 2014 dhe ky propozim vendim i sotit nuk ndryshon sipërfaqja aspak, është i njëjtë. Rekomandimet e komisionit nuk e kanë bazën ligjore sa e ka vendimi i Kuvendit, kështu që, sipërfaqja nuk ndryshon aspak. Mbikëqyrja, pikërisht për këtë investitor nga ana e kryetarit është formu komisioni para dy vite nga Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Zhvillimit, Urbanizimi, Kadastru, janë këta anëtarë të këtij komisioni, të cilët janë obligativ me përcjell punën e investitorit, ndërsa dëmet që mundet me i shkaktuar nga rritja e kapacitetit, janë pikërisht pëlqimet që kanë ardh nga ministrinë e linjës, nga Drejtoria e Urbanizimit, janë ata që kanë dhënë pëlqimet, i kanë analizuar këto problematika, që mundet të shfaqen, janë profesionist të caktuar, që i kanë paraprirë këtij propozim vendim. Unë kërkoj nga ju që të votohet ky propozim vendim.

znj.Mirlinda Sadiku: Drejtoresh, pavarësisht që jam magjistre e kulturës fizike, megjithatë kur kemi dyshime i kemi grupet punuese në kuadër të VV-së dhe dimë me i lexu numrat zonje e nderume. Këtu thotë, sipërfaqja 9410m² në zonën kadastrale në Kabash, në pronësi të Komunës së Vitisë, e protokollime në vitin 2014, kurse propozim vendim që na keni sjell është 8135m². A janë njëjtë këto, tregona të lutem ose ki bë gabim teknik ose diçka nuk po përputhet.

Drejtoresha znj.Fatbardha Emini: Unë e kam vendimin e Kuvendit të datës 24.12.2014, vendim i Kuvendit ku nuk ndryshon sipërfaqja e atij vendimi, ke këtë propozim vendime, nuk e di çfarë dokumente je ka keshyr ti.

z.Remzi Salihu: Sa i përket kësaj problematike që unë e ceka, unë fort mire e përmenda rekomandimin, vendimin, dhe tani propozim vendimin dhe thash të vendimi dhe propozim vendimi plotësohen shifrat, kurse të rekomandimi kemi një shifër tjetër, dhe tash çka bën me dallu aty, kur parcelat apo zonat kadastrale numër për numër përputhen, kurse metrat katrore nuk na dalin të njëjta edhe të rekomandimi parcelat

përputhen numër për numër. Nuk ka kurfar ndryshimi, tash shtrohet pyetja, si është e mundshme, kur të njëjtat parcela janë, kurse sipërfaqja është e ndryshme, te rekomandimi është mospërputhja jo të vendimet.

Kryetari z.Sokol Haliti: Përshëndetje të nderuar asamblast! Ne asgjë me pak nuk po bëjmë, vetëm po e kryem shërbimin institucional që e kemi me ligj, po i shërbejmë qytetarët, bizneset, standardet, po e kryem një obligim, që është i dal nga niveli qendror, për shkak se niveli komunal është marr me këtë temë. Po tash na ka rrjedhe sipas kërkesës se investitorit, ka rreth detyrimi nga niveli qendror, dhe kjo është transparenca dhe llogaridhënia. E kemi qit edhe në KPF dhe në Kuvend, mire që po debatoni, për këtë jemi këtu, unë ju përshëndes për punën e mirë që po e bëni ne Kuvend, unë sot isha në takim me ministrin e Infrastrukturës, biseduam për temat që i kemi diskutu edhe këtu, nënshkruam memorandume për disa rruge infrastrukturale në Komunën tone me interes, ku në agjendë e kisha edhe kyqjen ne Gerlicë, ku sipas vendimit të Kuvendit që e kemi bë të gjithë grupet parlamentare sipas vullnetit të qytetarëve, dhe kërkoja kyqje ne Gerlicë. Ministri u shpreh shumë fleksibil, në këtë kuptim vendimi ndërministror është, shpresojmë shume se do te implementohet, për këtë u vonova, sepse kam pas me ardh prej fillimi në këtë seancë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim: Kush është që të miratohet kjo pikë? Konstatoj që me 15 votat pro, 4 kundër dhe 4 abstenime, konstatoj që me votat e shumicës së kuvendit u miratu kjo pike e rendit të ditës.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për emërimin e Komitetit për Arsim, Kulture, Rini dhe Sport

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë para Kuvendit Komunal kam pru propozimet, katër propozim vendime për formimin e komisioneve joobligative, të cilët do ta kenë rendin e vete ne aspektin e këshillëdhënësës së kuvendit komunal. Unë hapi debat për diskutimin e këtij komitetit, ju lus që te jemi kujdesshëm ne aspektin gjinore.

znj.Mirlinda Sadiku: Pavarësisht që janë komitete joobligative, e luajnë një rol shume të rëndësishëm, sidomos Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Po ashtu ky komitet, mirëpo e kam një dro skepticizmi, për arsye, se nuk po paguhen pak edhe neglizhenca, e nuk po e kryen funksionin për te cilin janë thirr. Kemi një provoj te hidhur ne legjislacionin e kaluar, ku sidomos arsimit ka një grumbull të problemeve dhe shume pak është punu në atë drejtim, shume pak edhe shëndetësia. Prandaj, jam pak e dyshimtë që do ta kryen funksionin për të cilin janë thirr, pikërisht për shkak se nuk po ka mëditje.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë kisha mi qit të gjitha këto propozime me një votim dhe mandej t'i jepni ju dy grupe emrat. A jeni që ne parim t'i votojmë të gjitha këto katër propozim vendimet që i kemi para vete, ju lutem me ngritje dore. Konstatoj, që nga të gjithë u miratuan këto katër propozim vendime.

Unë tash kërkoj për Komitetin për Arsim, Kulturë dhe Sport: nga LDK jepna një emër, Basri Sylejmani; VV, Mirlinda Sadiku; PDK, Samet Idrizi[AAK, Vehbi Rama. Konstatojmë që Komitetit për Arsim, Kulturë dhe Sport do të jet nga kjo përbërje, siç u propozuan më lartë. Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, nga LDK, Xhilsime Qamili; VV, Liridona Bislimi; PDK, Idajete Pira; AAK, Ekrem Abazi. Komiteti për Shërbime Publike: LDK, Zekirja Zuka; VV, Sejdi Emini; PDK, Avdi Rexhepi; AAK, Liridona Hasani. Komitetit per Planifikim: LDK, Rufadije Rexhepi; VV, Jakup Demiri; PDK, Taulant Haxhiu[AKR Besim Ymeri.

Ne në seancën e kaluar e kemi formuar komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, dhe këtu ministria na ka sugjeru nga shoqëria civile, e kemi pas z.Tefik Salihun nga fshati Smirë, i cili na ka lajmëru që është i gatshëm që të zëvendësohet me znj.Melihate Osmani. Unë po e qes ne votim, që të bëhet ky ndryshim plotësimi i këtij vendimi, që z.Tefik Salihu të zëvendësohet me znj.Melihate Osmani. Ju lutem me ngritje dore, konstatoj që me votat e të

gjithëve u miratu ky ndryshim plotësim. Tani kalojmë ne pikat jashtë rendit të ditës. Në pyetje dhe përgjigje, ju lutem kush e do fjalën?

z.Nuredin Lutfiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike. Nga banoret e fsh. Skifteraj, banoret kërkojnë intervenim ne kanalizim, sepse në dy vende është blloku dhe kanalizimi ka dal mbi sipërfaqe, ndërsa te ujësjellësi e di që ka një marrëveshje me një kompani zvicerane, por banoret pyesin se deri ku kanë shku procedurat lidhur me këtë temë.

z.Nijazi Isaku: Te nderuar të pranishëm, kame dy pyetje për dy drejtorat, për drejtorin e Shërbimeve Publike dhe drejtorin e Bujqësisë, por fillimisht po du mu ndërlidh, tash reshjet e bores që kane shkaktu vështirësi ne komunikacion: A kanë ndërmarr hapa, p.sh.: rrugët kryesore për mu liru. Një nder rrugët Viti-Pozharan është shumë e keqe, e pa kalueshme. Lidhur me vërshimet që ndodhen në fillim të këtij muaji, saktësisht me datën 3 shkurt. Siç jeni në dijeni, këto vërshimet ishin shumë të mëdha në komunën tonë, ku kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekonomitë familjare. Si në rr.”Elena Gjika” dhe në fushat e mjellura me kultura të ndryshme. Pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, lidhur me dëmin në ekonomitë familjare: sa familje janë prekur nga vërshimet dhe cilat janë masat të cilat i keni ndërmarr për kompensimin e dëmit ndaj këtyre familjeve? Po ashtu, vërshimi ka ndodhur brenda qytetit si në qendër dhe në rrugën “Idriz Seferi”, ku është devijuar drejtimi i ujit për në drejtim të lumit “Morava”. A keni ndërmarr apo keni planifikuar ndonjë masë të parandalimit apo të sanimit të shtratit ka rrjedh uji i përroskës. Gjithashtu, dëm të konsiderueshëm ka ndodhur në fushat, ku ka pasur mbledhje të grurit apo ndonjë kulturë tjetër. Andaj, pyetje për drejtorin e Bujqësisë: a keni informata sa është dëmi nga këta vërshime dhe a keni nda fonde për t’i kompensuar bujqit e prekur nga këto vërshime?

znj.Mirlinda Sadiku: Për drejtorin e Arsimit pyetje, mësimi jo formal në vitin 2013, 13 profesor nuk janë pagu, është pagu klasa 11, klasa 12: pse nuk ka ndodh, ku qëndron problemi. Buxheti i MASH-it për infrastrukturën në arsim parauniversitar i ka nda dikun 10 milion e 810 mije euro, ky buxhet është nda 500 mije euro për blerjen e pajisjeve për sallat e edukatës fizike. Këto janë të dhëna të sakta të marra prej faqes së Ministrisë së Financave. Më intereson ta di, prej zyrës se juaj a ka shku ndonjë kërkesë, që e din se salla e edukatës fizike që tri vite operon jo me pajisje përcjellëse, të cilat duhet t’i ketë për me zhvillu një ore të edukimit fizik. Kolegu Taulanti e pat përmendë për ata 12 fëmijë nxënës, të cilët nuk po mujn me viju mësimin për shkak të transportit ligjërish keni të drejtë, se nuk keni të drejt me ja pagu, mirëpo a keni mendu ndonjëherë me bisedu me kryetarin e komunës, që ne kuadër të subvencioneve që i ndajnë nga zyra e tije, te ju jepet një lloj burse, që këta fëmijë, mos të kenë vështirësi që me ardh në shkollë. Kame 5 raste, nxanësa të shkollës së mesme profesionale, dy prej këtyre një ditë kanë qenë të rrezikuar edhe prej qenve endacak, e cila është dukuri shumë e shprehur në komunë tonë, prandaj me bë zgjidhje për këta nxanësa, se është gjyna ata fëmijë me met jashtë bankave shkollore, kur e dimë që një distancë është prej 14 kilometra. Pyetje për nënkryetarin, ekziston një vendim për themelimin e ndërmarrjes publike komunale. Natyrisht ky vendim është marr me 15.04.2013, për menaxhimin e mbeturinave në Komunë të Vitisë. Drejtoria e inspeksionit e ka padit kompaninë “Ekohigjiena”, ku e kishin fitu gjyqin 1000 euro, për shkak se nuk e ka bë menaxhimin e mbeturinave si duhet, d.m.th tash kemi një vendim të vitit 2013, që është themelu kjo kompani. Kryetari nja dy tri herë e ka premtu ne këtë foltore, se do ta themelojmë një kompani publike për menaxhimin e mbeturinave. Ju e dini shume mire, se me 31.07.2015 e kemi liru nga detyra ky Kuvend personin i cili ka qenë përfaqësues në bordin e kësaj kompanie, prandaj thamë shkurt, Vitia nuk e ka zërin e saj në këtë kompani dhe po ashtu në bazë të një procedure gjyqësore u vërtetu, se këto pajisje janë shit edhe për hekura, prandaj duhet të behet një zgjidhje. E di që ka shume deponi ilegale të mbeturinave. Kisha kerku nga Drejtoria e Shëndetësisë, që këtij kuvendi të ja sjell një raport lidhur me marrëveshjen që ka me KARITAS-in. Vitin e kaluar 2017, sa persona kanë qenë të punësuar, a janë pagu ata njerëz. Për drejtorin e Bujqësisë, ka fundi i mandatit na pate premtu që ki me hap kanal in e lagjes “Zejnnullahu”, prapë vërshimet

e fundit ka be dëme, e kame dokumentu me foto shumë herë, do të isha mirënjohëse që në agjentin e juaj të punës ta kishe këtë vit.

z.Zekirja Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kam një pyetje dhe një kërkesë për drejtorin e Arsimit. Sa shkolla në Komunën tonë janë të pajisura me laborator te lendeve ekzakte, kimi, fizik, biologji, dhe nëse ka, a e din Drejtoria e Arsimit, se a përdoren ato dhe a zhvillohet ndonjë ushtrim laboratorik. Ndërsa, kërkesa me gjimnazin e “Kuvendit të Lezhës” ne një vizitë. Në cilësinë e prindërit që isha, disa profesor kujdestar klase u ankuan për pa pastërti, arsyeja nuk ishte që punëtorët e arsimit nuk punojnë, po arsyeja ishte, se shumë pak ka punëtorë të pastrimit. Kërkojnë nga DKA-ja te shton numrin e punëtorëve të pastrimi, në mënyrë që te ketë pastërti me te madhe në at shkollë.

z.Sejdi Emini: Ne ditën e Pavarësisë se Kosovës, të gjitha subjektet politike bëjnë nderime te varrezat ne faqe të komunës, e pash që vetëm subjekti i VV nuk ishte prezent, nuk i bën mirë demokracisë tu e anashkalu këtë. Te Drejtoria e Arsimit një pyetje, droga nëpër shkollat e Komunës së Vitisë, kemi pasur raste ku të ritë po përfundojnë në fatalitet, pikërisht për shkak të drogës, a keni njohuri drejtor, a përdoret droga në shkollat e Komunës së Vitisë? Unë kame bisedu me disa punëtor, sidomos të shkolle së mesme, janë shqetësuar bukur shume, kanë than që ka raste. Mendoj që drejtorët e shkollave ku punojnë nuk duhet me i mshef këto raste, se shumicën e herav i mshefin për me than, se shkollën ku punoj unë nuk ka probleme. Mendoj, që nëse ka raste e ku unë mendoj që ka, është mirë me marr hapa urgjent. E ki një psikologe, nuk mjafton vetëm një, mirëpo me bë një pilot projekt e me vepru, që ne mënyrë sa me shpejt me i vetëdijesu këta të ri, se për ndryshe, nëse sot janë 10, vitin e ardhshëm ki mi pas 20. Prandaj, kjo kërkon përgjegjësi shume të ranë. Punëtorët e lehonisë po shkoj ne pushim 6 muaj, ndërsa punëtorët që i merrni paguhet për 5 muaj, e padrejtë. Pikërisht shkollën ku punoj unë janë dy për shkak se një dit nuk ka mujt me zënë për mi bë 6 muaj ose i leni me qellim e një muaj duhet me punu pa pagës, në fsh. Goshicë e kame ngrit disa her por prap sot poe ngriti sepse është shqetësim dhe është nevojë shume e madhe e qytetarëve dhe e banorëve që jetoj aty ujësjellësi ka shume kohe me herët që ka filluar dhe ende nuk ka përfunduar, po e thamë me përgjegjësi të lart, ka banor dhe ka familje që e ndërrojnë vendbanimi pikërisht për shkak të nevojës së ujit, e ki familjen Ahmeti që e ka ndërte vendbanimin, mirëpo e ki edhe familjen e Agim Idrizit, i cili ka hap dy a tre puse nga 40 metra dhe nuk i ka dal ujë. Ai tash është i gatshëm me i ndërte vendbanimin, pikërisht për çështjen e ujit. Apsolut nuk jam kundër asnjë projekti, mirëpo aty ku fillon te shkon për se mbari është projekt që ka fillu vite e tera me herët, prandaj, nuk është e drejtë ne raport me banoret, sepse ata mushin herë ne Kabash herë ne Lubisht, ku ta gjejnë veten. Kam edhe një kërkesë, ambulanca ka shume vite që ka funksionu në Goshicë, punëtorja ka shku ne pension, ligjin e keni përpara, nuk ka nevojë as nuk ka pas nevojë hiq unë me than, ka qenë dashtë ju vet me kompenzu ata, se është e drejt e qytetarit e drejt e popullatës. Edhe një problem do ta ngris, punën e Florim Limanit të kanalizimit e keni ngrit, jeni kane pikërisht me at banore edhe administratori i fshatit, kanalizimi nuk ka ramje aty i keni premtu që keni mi bë zgjidhje, nuk i keni bë, unë herën e par të vërshimeve i kame pa disa foto që i ka postu ne facbook, me te vërtet ishte mjerim, edhe këtu kërkoj, që sa me shpejt të intervenohet në mënyrë që të sanohet problemi ose për ndryshe ai zotëria atje ka mu detyru me padit kompaninë ose komunën, se ndryshe nuk po ka tjetër zgjidhje.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë e kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, rreth ndriçimit të qytezës së Pozharanit. Pikërisht qendra nuk funksionon një jave, funksionon një jave, jo gjysma e dritave funksionojnë, gjysma jo. Bile dje Radio Pozharani kishe bë një far ngjizmi, përmes facebook e kishe shpërnda, qysh u djege instalimi i rryme ne toke që paraqet shume rrezik për qytetaret, edhe një pyetje e kame rreth ndërtimit të stadiumit “Ibrahim Kurteshi”, nuk po dim se deri ku ka shku gjendja apo ndoshta po na pritni me ra prej lige e me tha që nuk po ju duhet më.

z.Bekim Azizi: Kryesues, po ti reduktoj pyetjet, sepse edhe unë pata përgatitë ma shume pyetje, masi kenë shume pyetje. Së pari isha lidh me te drejtori i Arsimit, a u zgjedh problemi ne Podgorc, ku është problemi tash, për shkak se ka pas ndërprerje te mësimi disa ditë, dhe tjetra për drejtorin e Arsimit, kisha ba pyetjen tjetër, te lënda djekëse nape shkolla, a ke informata, që sa kam informata, qe do shkolla janë keq dhe kushtet po shihen se temperaturat kane ra, po thamë qe ne teknik nëse nuk intervenohet shpejt, deri ne fund te javës ma shume nuk ka mundësi se nuk ka dru, besoj qe e keni parasysh. Ndërsa, pyetja tjetër e kisha lidh te pjesa e qytetit, ku është përball kishës qe janë vendos qeto baraka, mua s’mu ka dokë e mire, për shkak syrit, mirëpo është dashtë ne Kuvend te destinohet ai vend apo po tentohet te kthehet tregu prapë aty qe mua nuk mu ka doke diçka e mire, apo është marr vetëm pëlqimi i Drejtorisë se Urbanizmit, edhe është ba ne këtë formë. Nuk mu ka doke e mire qe te kthehet aty prapë një treg, se tregu është mirë qe është shmang prej qendrës,. E di qe ka qene një donacion, e di qe është ba nashta me vendim te mirë, mirëpo nuk e ka pas vendit aty. Faleminderit!

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje për te gjithë ju te nderuar! Unë pata qef me qenë këtu edhe kryetari Sokol Haliti. Ai pasi filloj debati ai u largu, ai duhet ti sheh replikat e asamblistëve te Komunës se Vitisë, ai u largu edhe shkoj. Kam një pyetje shume konkrete dhe te thjesht për drejtorin e Arsimit, pasi qe sot koka ne qendër te vëmendjes z.Qahil Sinani. Unë nga qytetaret e Komunës se Vitisë kam marr një video, te cilën e ka pa edhe drejtori i Arsimit, nxënësit e shkollës fillore “Dëshmoret e Vitisë” janë te rrezikum, ngase ne oborin e shkollës lëvizin automjetet. Unë kisha dashtë ta di një sqarim nga z.Qahil Sinani, a ka mundësi aty te ndalet qarkullimi i veturave, qe mos te rrezikohen nxënësit e kjo duhet te bahet sa me shpejt se rrezikon çdo dite e me shume nxënësit e shkollës fillore. E kemi videon nga qytetaret te cilën e ke pa edhe ti para dy dite. Pyetjen e dyte e kam për z.Nexhmedin Jakupin, z.Nexhmedin, bore nuk bje çdo dite, kur te bje bore duhet te jesh ma efikas qe te besh pastrimin e rrugëve nga organet kompetente. Unë e pata bërë një postim ne facebook, e keni pare gjithë, dhe aty kishte replika është ne kuadër te Ministrisë se Infrastrukturës. Qytetari të Komunës se Vitisë nuk i intereson në çfarë kompetenca, ai e njeh kryetarin e Komunës, kryetari i Komunës ka marr 52%, po ti kisha marr unë 52% vet e kisha kap lopatën t’i baj zgjidhje qytetarit të Vitisë. Kështu që lus organet kompetente, qe ne raste emergjente te jene ma efikas. Faleminderit!

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit Taulant, e ke mundësinë me konkuru, edhe ashtu ke qene ma i votuari ne partinë tanë, konkurro ne zgjedhjet e ardhshme.

z.Remzi Salihu: Edhe pse e votova kundër qe debati te bahet ne fund, po me duket po ma jep mundësinë te baj shume pyetje e jo vetëm dy pyetje. Megjithatë qëndroj pranë votimit tim, nuk luhatem. Sa për fillim një pyetje për drejtorinë e Urbanizmit. Se pari po ja përkujtoj drejtorit, se me vendimin për formimin e komisionit për emërtimin e rrugëve është marr me 29.04.2014 dhe rrugët janë emërtuar ne disa fshatra, por janë me shume se 63 ankesa dhe peticione me mbi 200 e ca nënshkrime me te cilat shprehin pakënaqësinë e tyre dhe nuk pajtohen me emërtimin e rrugëve. Dua te di dhe te informohem dhe t’i informoj qytetarët te interesuar për ketë: Pse për katër vite nuk janë shqyrtuar këto ankesa dhe këto peticione? Kërkoj qe sa me pare te formohet komisioni i ri, te kryhet sa me pare ky proces dhe mos ta neglizhon. Me sa jam ne dijeni, nëpër komuna tjera ky proces veç tash me është kryer dhe mund te themi se plotësisht u krye procesi i vënies se numrave nëpër shtëpi. Po ashtu ndoshta nuk i dedikohet nënkryetarit, po megjithatë do ta pyes edhe nënkryetarin rreth kësaj çështje, se çfarë ka ba kur me një mbledhje te këshillit te fshatit Remnik ka marr një përgjegjësi tillë, po flas për fshatin Remnik. Çështja tjetër, do te isha lidh me problemin e infrastrukturës ne fshatin Remnik, edhe nënkryetari edhe kryetari janë te fort informuar rreth problemit te kanalizimit te fshatit Remnik, ku ne dy pjese dalin ujërat e zeza mbi tokë dhe banoret e atij rrethi janë me se te rrezikuar, qe eventualisht munde te ndodhe aty edhe ndonjë epidemi. Prandaj, dua te di se çka është ndërmarr për këtë problematik dhe a është ndonjë proces e sipër. Kam edhe shume pyetje tjera, por po kursena e po e bej edhe një pyetje prape rreth ujësjellësit te fshatit Remnik, me qe Sejda e cekti për fshatin Goshice. Në Remnik nuk është ndoshta problematike shume e madhe ashtu siç është ne Goshicë, por

megjithatë ne Remnik është bere rrjeti i ujës-jellësit ka disa vite ne mandatin e z.Nexhmedinit, po qe atëherë është mbet i tillë dhe nuk është furnizua fshati me ujë. Ku qëndron puna dhe deri sa është mbërri me këtë problematikë.

z.Ali Bajrami: Unë nuk kam as pyetje e as kërkesë, kam një falënderim me kërkesë të shumë qytetareve. Pikërisht do te ndërlihem në natën 3 dhe 4 shkurtit, vërshimit gjate reshjeve atmosferike, kisha falenderu drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe njësitin e zjarrfikësve, që gjatë tërë natën kanë qenë ne vendet ku ka pas vërshime dhe kanë kryer një pune shumë të mirë dhe të suksesshme ne evitimin e pasojave ma te mdhaja për qytetaret e Komunës se Vitisë.

z.Besim Ymeri: Pata një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike. Po ndërlihdna me Aliun, se zjarrfiksat e natës 3 dhe 4 Shkurtit kane punu ne mënyre te jashtëzakonshme, a i keni përgatit apo a i keni dhanë najfare simulimi për atë punë qe është ba, se personalisht i kam pa dikun rreth orës 1 të natës me kazem e lopata kane shërby në interes të qytetarit të Komunës, një dhe e dyta, për inspeksionin, për inspektorin e kam fjalën: a keni marr ndonjë masë, ku ne vendin ku ka pas vërshime janë vërejt mbi 200 thas shisha te plastikes, a keni marr naj masë dhe a e keni xhobite najkan për ketë veprim jo te hijshëm te qytetareve qe i hedhin ato në lum.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë! Unë kame një pyetje për nënkryetarin, njëra prej kompanive që ka konkuru për dje ka pas mu bë hapja e një tenderi për shtrimin e tepisonave, dysHEMEVE ne Komunë të vjetër, ndërsa të Dielën dikush ka punu aty. Po du me dite një sqarim me dhanë dhe a ka mundësi me pa naj kontratë të atyre që kane punu të Dielën, si qëndron puna këtu dhe a është e vërtet kjo?.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë dua të ngris një çështje lidhur me fshatin Drobesh, ne rrugën magjistrale Viti-Gerlicë, e cila dijet që ka një qarkullim shumë të dendur të automjeteve, dhe kjo çështje është ngritur edhe në mandatin e kaluar, mirëpo asnjëherë nuk është ndërmarrë asgjë. Gjithashtu edhe gjatë fushatës elektorale ne shtator të vitit të kaluar, këta banor kane bë kërkesë gjatë vizitës në këtë fshat, ku ka qenë drejtori për Financa dhe nënkryetari, pastaj edhe nga vet kryetari Sokol Haliti është bë një premtim i tillë, pra përkundër te gjithë rreziqeve dhe rasteve me aksidente që kanë qenë edhe me fatalitet nga banoret, kërkohet që të bëhet një nënkallim ose një mbikalim ne këtë rrugë ose të gjendet një zgjidhje sa me e shpejtë.

Drejtori z.Qahil Sinani: Përshëndetje për të gjithë! Mësimin joformal duhet me pa këtë nuk kam përgjigje tani, te nxanesat e Debuldehut, është e vërtet që nuk kemi të drejtë mi pagu, nuk është e vërtet se kryetari nuk ju ka ndihmu, ju ka ndihmu shumë, ju ka dhanë lëndëd djegëse, kambii, i cili i ka bart, por për burse me nda nuk kem të drejtë për shkollë të mesme, laborator, ka kabinete, po jo krejt nuk janë funksionale, se janë shumë të vjetër. Prandaj, laborator, nuk ka, marrëveshja me Kosove- Luksemburg, Ministri dhe Komune, që janë afër 100 mije euro. Është kry nënshkrimi aty, do të jeni furnizim me digjitalizim të shkollave me kompjutera, me krejt nuk shkon larg kjo. Pritet shpërndarja nëpër shkolla, ne gjimnaz u tha pa pastërti, 400m² janë ne krye të punëtorit teknik për pastërti. Është e vërtet që ka pak, po është e vërtet se që 2300 nxënësia i kemi me pak, ka ra nr. i nxënësve, ministra ka vënë në kokë të nxënësit jemi në minus me nxënësia, por jemi në minus edhe me punëtorë. Droga nëpër shkolla, nuk ka drogë nëpër shkolla, të paktën ne nuk kemi njohuri rreth kësaj. Qa flitet nëpër kafe është diçka tjetër, por zyrtare nuk kemi asnjë ankesë që ka drogë nëpër shkolla. Çështja e Potgorcit, është kry, nuk kemi çka me diskutua. Landë djegëse, i kemi dërguar mbi 60 metra kush i ka kërkuar. Te shkolla “Dëshmoret e Vitisë” është duke u bërë parkingu, edhe nuk do të lejojme ma të hyn brenda oborrit të shkollës.

Kryesuesi: Ja kisha dhanë fjalën drejtorit të Shërbimeve Publike, u shtruan një numër i pyetjeve edhe për këtë drejtori.

Drejtori z. Nexhmedin Jakupi: U parashtruan një numër i pyetjeve për drejtorinë tonë, do të mundohet tu jap përgjigje. Rreth reshjeve 3-4 shkurt dhe vërshimeve. Unë kam përgatit një informatë për kryetarin e komunës, me 6 shkurt ne kemi shikuar dëmet që janë bërë gjatë këtyre vërshimeve, qe të ju dërgohet edhe

ministrisë, që nëse ka mundësi të paktën me u pagua dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet, dëmet ma të mëdha janë shkaktuar nga agjurnaturat e lumit “Morava”, ku dikun kemi intervenuar ku kemi pas mundësi. Ne kemi bërë pastrimin e prockave në disa vende të kanalizimit, ku kemi informata ne intervenojmë. Ujësjiellësi në Skifteraj, jemi në fazën e pestë të rehabilitimit, të cilën punë po e kryen CDI-ja dhe “Hidromorava”. Kryetari po bënë presion, që këto punë mu kry me shpejt. Kanalizimi në fshatin Skifteraj, do të intervenojmë si të heket bora. Ndryçimi në fshatin Pozharan. Ne para një jave kemi intervenu, pasi që ishin zbardh, rrjeti, kabllat e ndryçimit publik, ndërsa për dje ose pardje nuk kem pas informata, unë tash nga asamblisti u informova. Sa i përket pastrimi të rrugëve, jemi një nder komunat me të mira që i mbajt rrugët lokale gjatë këtyre viteve.

z.Veton Ademi: Përshëndetje të nderuar asamblist! Sa i përket pyetjes se vërshimeve që kanë ndodhur me 3 dhe 4 shkurt, sa i përket çështjes se bujqësisë, fatmirësisht për shkak të hapjes së shumicës së shtreteve të lumenjve nuk ka pas shume vërshime. Sa i përket tokave bujqësore, në këtë kohë kemi të mjellura grunë dhe dëmi ka qen mjaft i ulët, kryesisht ka pas vërshime në livadhet me kollosa. Ne kemi formu një komision i cili ka dal në vend të ngjarjes dhe dëmi është i vogël. Kemi pas vetëm një rast që kemi pas dëmtim të ushqimit të kafshëve, ndërsa për prockat të lagjja “Zejnullahu” në Skifteraj, unë kam kërku nga Zyra e Projekteve, që projektimi i kësaj të mbetet dhe besoj që gjate këtij viti do të futet në agjendë dhe do të rregullohet edhe kjo pjese e mbetur.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Ne Drejtorinë për Financa ka ardh një kërkesë nga krupi i këshilltarëve të VV-së për disa kërkesa që ne mu përgjigj me shkrim, me ato që ka ndodhe me ekzekutimin e buxhetit për vitin 2017. Unë i kame nxjerr përgjigjet, i kame të përgatitura, mirëpo kërkesën e ka bë një person që nuk përfaqëson grupin e këshilltarëve komunal të VV-se. Është Ilir Metushi. Unë kame të drejt para juve që me ju përgjigj çdo pyetje që parashtrohet me shkrim apo gojore, kam për detyrë me ju përgjigj. Unë nuk po di a është kërkesë e grupit të asamblistëve të VV-se apo ky qytetari e ka bë kërkesën në emër të tyre.

znj. Mirlinda Sadiku: Drejtor, si duket jeni keqkuptu, se këtu thuhet shume kjart, nga grupi i këshilltarëve të VV-së në Kuvendin Komunal të Vitisë, për shkaqe objektive që nuk kam qef mi humb orët e mësimit tek shkolla, atëherë e kam autorizu Ilir Metushin, i cili punon në zyre të VV-së, ai ka ardh e ka dërgu shkresën dhe e ka protokollu.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Ju faleminderit për pyetjet e parashtruara nga ju. Me të vërtet një përbërje e cila konsideron se premtion shume nga vete interesimi i juaj. Disa përgjigje u dhanë nga drejtorët. Është e vërtet që kame qenë në përbërje të atij Kuvendi, ku me një vendim u kane iniciativë për themelimin e një kompanie e quajtur “Natyra”, për çështjen e grumbullimit të mbeturinave, megjithatë nuk u jetësua ajo kur unë kame qenë këshilltar i Kuvendi Komunal. Kam qenë për me qu këtë proces përpara, e gjetëm një problem të cilin e dini ju, një kompani e cila është publiko-private, me 51 përqind privati, 49 është e kompanisë, e na ne qet 49 tu e përjashtu Gjilanin e Kamneicën, pjesa jote të cilën e kemi gjete që me iniciativën e kryetarit u ndryshu, tashi kemi hi me një përqindje, ku është një përqindje shume më e mire. E di që është në proces gjyqësor, nuk ka vendim ende përfundimtar, se qyshe e përfundon gjyqësia, a ka pas keqpërdorim apo janë shit ato mjete nuk e di, deri sa ta jep gjykata vendimi e vete përfundimtar. Numri i punëtorëve që u kane me KARITAS-in është bukur i madh, e di që jemi një nder komunat që me se miri i kemi të çështja e pagesave. Dikujt i kemi dy paga e dikujt një, por megjithatë nga shuma që e kemi bë pagesën na si komunë u deshtë me qenë hala me e mire kjo gjendje. Më vjen keq që nuk paska qenë ajo foto e subjektit të VV-se në wëp faqe, por më shumë me vjen keq që këshilltarët nuk e kanë kuptu pozitën e vet dhe nuk vinë kurr me kryesuesin me be homazhe. Ende janë në ombrellën e partisë, duhet me kuptu që institucioni Kuvendit është i te gjithëve. Çështja e ujësjiellësit, ke prej segmenteve që e kemi gjendje me se keqi në Komunën e Vitisë është çështja e ujësjiellësit, tu fillu prej Vitisë e në lokalitete. Megjithatë ju e dini që me CDI-në e kemi njëfar marrëveshje, po shkon pas si ngadal, por megjithatë me shpresë se do të behet më mire. E di rastin e atij kanalizimit, besoj që në këtë viti do të kryhet. Çështja e stadiumit në

Pozharan është çështje kohe, në këtë kohë sun fillojmë, se koha e keqe. Te çështja e emërtimit të rrugëve, është e vërtet se kemi qalu këtu. Ky qalim është për shkak të ankesave të cilat janë ardh prej shume lokaliteteve. Pse jem ballafaqu me këtë problem, se nga lista rezervë te cilët kanë qenë emrat e propozuar nuk kemi pas propozime nga ajo listë, po sikur të kishe pas nga lista rezervë nuk u kanë problem me hi ne procedurë, por kemi pas emra të cilët nuk janë kanë nga lista rezervë, po ka pas emër të ri. Pikërisht për këtë edhe atë zotimin që e kam marr ne Remnik, unë jam ai që e kame ndalu, që kam than, mos i qitni emrat, i cili është aprovu, por deri të shqyrtohet kërkesa le te rrinë. Çështja e kanalizimit të Remniki, kam bë përpjekje dy herë te kompanitë e ndryshe, kemi të bëjmë me një problem bukur të madh. Këtij problemi i cili u paraqit baze eksperteve të cilët kan dal në vendin e ngjarjes kane konstatu se dikun nga rruga që po shkon ne Nasal e deri në "Moravë" duhet me pas një kanalizim të ri, dhe pikërisht për kanalizim të ri është e pamundshme nëse nuk i ki të parashikume mjetet me bë, dhe intervenimi nuk ka pas sukses dhe pikërisht e kemi at gjendje, le që nuk e lakmoj por është tu me bë dam edhe mu shumë. Unë besoj që sivjet kemi me rregullu e me bë një zgjidhje afatgjatë. Ujësjiellësi në Remnik, është e vërtet që na e kemi pas kryq në mesin e tyre edhe ti Remzi ke qenë, edhe unë prej atyre që naj imponoj çështja e rrugës, e hajde ta shtim edhe rrjetin tani, masanej nga vete Këshilli i Fshatit kanë dal projekte që i kanë dhanë prioritet dhe kësaj jo dhe tash pamundësia buxhetore që me kry. Me pas mundësi pse mos me kry edhe ujësjiellësin. Jakup, është e lejuar edhe të Dielën me punu, sa problem. Çështjen me që e ngrite ti, me sa e di unë ka qenë një donacion që ka shpreh gatishmëri dikush, se pikërisht sot e ki pas edhe ministrin me ardh në at dysHEME dhe unë i falënderoj ata që e kanë bë këtë donacion. Nënkalimi apo mbikalim në Drobesh, na e dimë që me te vërtet paraqet rrezikshmëri, duhet të bëjmë zgjidhje, por megjithatë duhet ta kuptojmë, që është rrugë kompetencë e nivelit ministror, gjithherë kërkesat tona janë në konform të saj. Konsideroj që brenda këtij mandati do të kryhet edhe kjo.

z.Sejdi Emini: Te fotoja e cila nuk ka dal ne wep faqe te Komunës, për nder të Pavarsisë së Kosovës, nënkryetari gjithherë po keshyr me i barazu palët, mirëpo është mirë gjithherë me pranu fajin. Nënkryetar, ne si asamblist nuk e kemi problem asnjë me shku si Kuvend, me përfaqesu taman si na ka hije, mirëpo nëse unë ose cili do prej ne që vjen me juve sigurish që aty i keni edhe nja 20 a 30 të tjerë të partisë tuaj, që i jep kahje automatikisht partiake. Jam dakord qyshe prej sodit, nëse doni mu përfaqësu si Kuvend Komunal po jo të tjetër kryetar të pikave e të tjerë, se tani merr kaheje tjetër.

Nënkryetari z.Hsan Aliu: Ata të cilët kanë pas rastin me qenë në fillim të marrjes së mandatit, jo këtij mandati, të 2013-2014-së, që e kame udhëheq këshillin organizativ të rreshtimit, aty ata të cilët kanë pas rast me qenë aty, që ne e kemi bë një rreshtim, tu fillu prej kryetarit me ekzekutivin, kryesuesi i Kuvendit me këshilltarët komunal, me çka nuk e keni respektu, tash unë nuk muj me ja u imponu.

z.Nijazi Isaku: Edhe një korrektësi për drejtorin, po shkoj e pyeta për ekonomin familjare, jam bazu edhe në një raport të Plus Televizionit, te familja e Izet Zukes, që ka pas të dëmtuar, si ka deportu uji në shtëpinë e tij, për këtë ja bëra pyetjen për ekonomin familjare. E sa i përket protokollit, pajtohem me Sejden, nëse Kuvendi Komunal shkon si një bllok, në rregull mire ose nëse e parasheh komuna me protokoll ne rregull, shkojmë së bashku Kuvendi.

z.Basri Sylejmani: Unë do t'i tregoj Sejdes, se unë me Sejden bëra hajgare, tu ardh i thash a mos po ju ha e ai tha nuk ki dhëmb me na hanger, po nëse ja nismi për ka dhëmbët Sejd, i provojmë kur të duash nuk ka problem.

Kryesuesi z.Naim Pira Ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë për këtë seancë.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:30 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
